



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
KOMISIONI I ZGJEDHJEVE NË FAKULTET
FAKULTETI EKONOMIK

Nr. 02 prot.

Shkodër, më 27/05 2024

VENDIM


Nr. 02 datë 27/05/2024

Për hapjen e procesit të aplikimeve për regjistrimin e kandidatëve për "Dekan të njësisë kryesore" dhe "Përgjegjës të njësisë bazë"


Komisioni zgjedhor i Fakultetit Ekonomik (KZF-FE), bazuar në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Urdhrin nr. 101, i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, datë 13.03.2024 "Për shpalljen e ditës së fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Shkodrës", në Statutin e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" dhe në Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në USH" neni 17, pika 3 vendosi:


1. Hapjen e procesit të aplikimeve për regjistrimin e kandidatëve për "Dekan të njësisë kryesore" dhe "Përgjegjës të njësisë bazë" nga data 28.05.2024 deri më datë 01.06.2024 nga ora 10:00 - 14:00.
2. Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatët për këto dy struktura gjendet në Rregulloren e zgjedhjeve "Për Organizimin e zgjedhjeve për Autoritetet Drejtuese dhe Senatin Akademik në USH", neni 22 dhe 23.
3. Ky dokumentacion dorëzohet pranë Sekretarisë së KZF-FE tek godina e FE, salla e video-konferencave (Salla e Doktoraturës).

Kryetar

Albana Kastrati 

Anëtar

Sead Baraku 

Edmond Armeni 

Sekretar

Arian Gjura 